



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA THEMELORE PRIZREN

---

Numri i lëndës: 2018:010751

Datë: 31.07.2018

Numri i dokumentit: 00093457

**P.nr.9/18**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti për krime të rënda,** kryetarja e trupit – gjyqtarja Ajser Skenderi dhe anëtarët e trupit-gjyqëtarët Kymete Kicaj dhe Artan Sejrani ,me procesmbajtësen Nazan Kuqani , në çështjen penale kundër të akuzuarit V. S. nga Prizreni, për shkak të veprës penale blerja, posedimi shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par.l. të KP, duke vendosur sipas aktakuzës së PSH në Prizren PP/I nr.167/17 të datës 29.01.2018 , pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar në prezencën e Prokurorit të Shtetit Ervehe Gashi ,të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij av.M. Q. me datën 26.07.2018 muarr dhe publikisht e shpalli këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I akuzuari:**

**V. S.** , nga i ati S. dhe e ëma L. – e lindur B. , i lindur më *data e lindjes...* në Prizren , me vendbanim në Prizren rr.... nr... i pa martuar, e ka të kryer shkollën fillore, kamarier, i gjendjes së varfër ekonomike, Shqiptar – shtetas i Republikës së Kosovës,

**ËSHTË FAJTOR**

Se më datën 13.10.2017 në Prizren në rrugën .... n; shtëpin nr. ..., pronë e S. S. nga Prizreni përndryshe babai i të pandehurit, policia në dhomën e të pandehurit gjen dhe sekuestron një (1) paketim me substancë të dyshuar për narkotik të llojit marihuanë në peshë prej 34.51 gram , e të cilat i pandehuri V. S. e kishte blerë nga një person shtetas i Shqipërisë dhe e ka poseduar pa autorizim me qëllim të shitjes dhe shpërndarjes.

-Këso dore ka kryer veprën penale blerja, posedimi ,shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve ,substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par.1. të KP.

Andaj gjykata konform dispozitave të nenit 7,17,41,45,46,47,73,80,83 në lidhje me nenin 273 par.1 të KP e

## G J Y K O N

Me dënim me gjobë në shumën prej **500 eurove** si dhe me dënim me burgim në kohëzgjatje prej **6 /gjashtë /muajve** në të cilin dënim me burgim do ti llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim prej datës 13.10.2017 deri më 03.11.2017 dhe se sipas **marrëveshjes së arritur dënimi me burgim prej gjashtë (6) muajve** shndërohet në dënim me gjobë në shumën prej 2000 eurove.

Andaj gjykata të njejtit konform nenit 80 par.2 pika 2.4 të KP ia shqipton **dënimin unik me gjobë në shumën prej 2.500 /dymijëepesëqind/eurove** të cilin dënim me gjobë i akuzuari V. S. është i obliguar që të paguaj në afat prej 15 ditëve pas plotëfuqishmërisë së aktgjykimit.Poqëse i njejtë nuk dëshiron ose nuk mund ta paguaj gjobën atëherë dënimi me gjobë do të zëvendësohet me dënim me burg ashtuqë një ditë burgim do të llogaritet 20 Euro gjobë.

Obligohet i akuzuari që në emër të paushallit gjyqësor të kësaj gjykate të paguajë shumën prej 150 Euro, të gjitha në afat prej 15 dite pas plotëfuqishmërisë së aktgjykimit.

Konform Ligjit për kompenzimin e viktimave të krimit obligohet i akuzuari V. S. që të paguaj shumën prej 50 Eurove në afat prej 15 ditëve pas plotëfuqishmëris së aktgjykimit .

## A r s y e t i m

PSH në Prizren kësaj gjykate ka parashtruar aktakuzën PP/I.nr.167/17 të datës 29.01.2018, si dhe marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë kundër të akuzuarit V. S. nga Prizreni, për shkak të veprës penale blerja, posedimi,shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotivëve substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par 1 të KP-së. Gjatë shqyrtimit gjyqësor prokurorria e shtetit ka propozuar pranimin e marrëveshjes si dhe që gjykata të aprovoj edhe dënimin e rekomanduar si në marrëveshje ngase në momentin kur është arritur marrëveshja dënimi është rekomanduar konform peshës së narkotikut dhe llojit që është gjetur te i akuzuari dhe rrethanave ekonomike të të akuzuarit.

I akuzuari V. S. gjatë shqyrtimit ka theksuar se në prezencën e mbrojtësit të tij ka lidhur marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë, pasi që paraprakisht i është shpjeguar natyra dhe pasojat e pranimin të fajësisë dhe e lidhjes së marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë, marrëveshjen e ka lidhur me vullnetin e lirë, pa kurrfarë presioni dhe kërcënimi, poashtu është pajtuar edhe me dënimin e rekomanduar, andaj ka propozuar që gjykata ta aprovon në tërësi marrëveshjen e arritur.

Mbrojtësi i të pandehurit avokat M. Q. poashtu ka propozuar që të aprovohet në tërësi marrëveshja si dhe dënimi i rekomanduar me marrëveshje pasi që i mbrojturi i tij me vullnet të lirë ka pranuar të lidhë këtë marrëveshje.

Në shqyrtimin gjyqësor pasi që i akuzuari e ka pranuar fajsinë për veprën penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par.1. të KP gjykata e aprovoi pranimin e fajësisë konform nenit 248 të KPP, poashtu e ka pranuar edhe marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë të lidhur konformë nenit 233 par.18 të KPP, pasi që i akuzuari ka kuptuar pasojat e pranimin të fajësisë, pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësin e tij, pranimi i fajësisë mbështet në fakte dhe prova materijale të rastit konkret dhe se nuk ekzistojnë asnjë nga rrethanat e parapara në nenin 253 par.1. dhe 2. të këtij kodi, gjykata ka vërtetuar se në veprimet e të akuzuarit formohen elementet qenësore të veprës së lartëcekur penale pasi që më datën 13.10.2017 në Prizren në rrugën ... në shtëpin nr..., pronë e S. S. nga Prizreni përndryshe babai i të pandehurit, policia në dhomën e të pandehurit gjen dhe sekuestron një (1) paketim me substancë të dyshuar për narkotik të llojit marihuanë në pesh prej 34.51 gram , e të cilat i pandehuri V. S. kishte blerë nga një person shtetas i Shqipëris dhe e ka poseduar pa autorizim me qëllim të shitjes dhe shpërndarjes.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin konformë nenit 41 të KP, përkitazi me llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat të cilat ndikojnë në të njejtën duke marrë parasysh qëllimin e dënimit, të gjitha rrethanat të cilat ndikojnë në zbutjen apo rritjen e dënimit, shkallën e përgjegjësisë, motivet nga të cilat është kryer vepra, prej rrethanave lehtësuese morri parasysh faktin se i akuzuari e ka pranuar fajsinë, dhe ka arritur marrëveshje mbi pranimin e fajësisë, mbajtjen korrekte të tij në gjykim dhe moshën relativisht të re si dhe gjendjen e tij materiale. Si rrethana rënduese morri parasysh motivin e kryerjes së veprës penale-e që është për përfitime materiale, faktin se kemi të bëjmë me supstancë narkotike të ndaluara sipas Ligjit për barënat narkotike, supstancat psikotrope dhe prekursor, andaj është mendimi i gjykatës që dënimi i shqiptuar do ta arrijë qëllimin e vet konformë nenit 41 të KP, se dënimi i shqiptuar është në harmoni me intenzitetin e dëmtimit të vlerës së mbrojtur, si dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit dhe se do të mundësoj një balans të drejtë në mes të kërkesave që të akuzuarit ti mundësohet risocializimi dhe kërkesës së shoqërisë që ai dënim me peshën e tij të ketë karakter të përgjithshëm parandalues nga kryerja e veprave penale, të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit të respektimit të ligjit. Gjukata është e mendimit se dënimi i shqiptuar të akuzuarit është në shërbim të preventivës së përgjithshme, posaqërisht të asaj të posaçme, se do të ndikoj në forcimin e moralit të shoqërisë, përgjegjësisë dhe disiplinës së qytetarëve dhe është në pajtueshmëri me kërkesat për siguri personale të popullatës së kësaj treve dhe se me këtë dënim do të mund të arrihet qëllimi i dënimit në të gjitha segmentet e tij.

Nga të lartëcekurat u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

Vendimi mbi llogaritjen e paraburgimit në denimin e shqiptuar është marrë konform nenit 83 par.1 të KP.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është marrë konformë nenit 450 par.2 pika 2. 6 në lidhje me nenin 453 par.1. të KPP.

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN  
DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA ,**

**2018:010751, 31.07.2018**

**Kyetarja e trupit gjykues  
Ajsër Skenderi**

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga koha e pranimi të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.